# IQOS
# ILUMA

Udhëzuesi i përdoruesit

| | | | |
|---|---|---|---|
| Hogarth Worldwide | Project and Job Number<br>**CR13082_H266288_P600287** | Client<br>**Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) |
| | Publication | Market<br>**Global** | Trim Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| | Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| | Contact | | Date & Time<br>**19/05/2023 21:36** |

| | |
|---|---|
| Operator | Proofreader |
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

## KARIKUESI I XHEPIT IQOS ILUMA™




## MBAJTËSI IQOS ILUMA™




IQOS ILUMA™ është e përputhshme vetëm me fijet SMARTCORE STICKS™

| Hogarth Worldwide | Project and Job Number<br>**CR13082_H266288_P600287** | Client<br>**Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) | Operator | Proofreader |
|---|---|---|---|---|---|
| | Publication | Market<br>**Global** | Trim Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** | Line Manager | Account Manager |
| | Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** | Light Box | Light Box |
| | Contact | | Date & Time<br>**19/05/2023 21:36** | | |

GREY
Black

## Karikimi



Kablloja e karikimit



Përshtatësi i energjisë

myIQOS

Për **udhëzuesin e plotë të përdorimit**, **kujdesin e klientit** dhe **shërbimet e zgjeruara të asistencës për përdoruesit e IQOS**, vizitoni

**www.iqos.com/myiqos**

### VEÇORITË DHE CILËSIMET

Mund të aktivizohen ose çaktivizohen me aplikacionet IQOS*.

Regjistrohuni duke skanuar kodin QR ose lidhuni në **www.iqos.com/iluma** dhe ndiqni udhëzimet.

* Aplikacionet IQOS mund të mos jenë të disponueshme në vendin tuaj.


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number | Client | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|
| **CR13082_H266288_P600287** | **Philip Morris International** | |
| Publication | Market **Global** | Trim Box (h x w) **140.00 x 80.00 mm** |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w) **140.00 x 80.00 mm** |
| Contact | | Date & Time **19/05/2023 21:36** |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black
BLUE

# Fillimi




NDIZENI
Mbani shtypur butonin e karikuesit të xhepit për 4 sekonda, më pas lëshojeni; Dritat e statusit të karikuesit të xhepit dhe dritat e statusit të mbajtësit do të ndizen ngadalë.



NGARKONI MBAJTËSIN
Futeni mbajtësin në karikuesin e xhepit për ta ngarkuar.

Drita e statusit të mbajtësit do të shfaqë nivelin e baterisë së mbajtësit.



NGARKONI KARIKUESIN E XHEPIT
Para përdorimit të parë, ngarkojeni plotësisht pajisjen me përshtatësin e energjisë dhe kabllon e karikimit.

(rreth 135 min.)


Hogarth Worldwide

| | | |
|---|---|---|
| Project and Job Number **CR13082_H266288_P600287** | Client **Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) |
| Publication | Market **Global** | Trim Box (h x w) **140.00 x 80.00 mm** |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w) **140.00 x 80.00 mm** |
| Contact | | Date & Time **19/05/2023 21:36** |

| | |
|---|---|
| Operator | Proofreader |
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black
LIGHT GREY

# Si ta përdorni IQOS ILUMA™



**1. FUTNI FIJEN SMARTCORE STICK™**

Futni fijen SMARTCORE STICK™ në vijën mbi filtër derisa mbajtësi të dridhet dhe një ose më shumë drita të pulsojnë.

Ngrohja fillon automatikisht ose duke shtypur butonin për 1 sekondë.




**2. FILLONI PËRDORIMIN**

Filloni ta përdorni pasi mbajtësi të dridhet dhe dritat të qëndrojnë të palëvizshme.



**3. POTHUAJSE NË PËRFUNDIM**

Për të sinjalizuar 30 sekondat e fundit ose 2 thithjet e fundit, mbajtësi do të dridhet me një ose më shumë drita pulsuese me ngjyrë të bardhë.



**4. HIQNI FIJEN SMARTCORE STICK™**

Hiqni fijen e përdorur SMARTCORE STICK™ dhe hidheni sipas paralajmërimeve dhe udhëzimeve të sigurisë.


Hogarth Worldwide

| | | |
|---|---|---|
| Project and Job Number<br>**CR13082_H266288_P600287** | Client<br>**Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) |
| Publication | Market<br>**Global** | Trim Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| Contact | | Date & Time<br>**19/05/2023 21:36** |

| | |
|---|---|
| Operator | Proofreader |
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black
LIGHT GREY

# Si ta përdorni IQOS ILUMA™



5. RINGARKONI MBAJTËSIN
Futeni mbajtësin në karikues për ringarkim.


Hogarth Worldwide

| | | |
|---|---|---|
| Project and Job Number<br>**CR13082_H266288_P600287** | Client<br>**Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) |
| Publication | Market<br>**Global** | Trim Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| Contact | | Date & Time<br>**19/05/2023 21:36** |

| | |
|---|---|
| Operator | Proofreader |
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black
LIGHT GREY

# Këshilla të shpejta




**KONTROLLONI STATUSIN E MBAJTËSIT**
Anojeni mbajtësin drejt vetes ose shtypni shkurt butonin. Dritat e mbajtësit tregojnë nivelin e baterisë së mbajtësit.




**KONTROLLONI STATUSIN E MBAJTËSIT NË KARIKUESIN E XHEPIT**
Shtypni shkurt butonin e karikuesit të xhepit. Drita e statusit të mbajtësit do të ndizet.



**KONTROLLONI STATUSIN E KARIKUESIT TË XHEPIT**
Shtypni shkurt butonin e karikuesit të xhepit. Dritat e statusit të karikuesit të xhepit do të ndizen për të treguar nivelin e baterisë.



**NDALIMI AUTOMATIK**
Gjatë përdorimit, përvoja do të ndalojë nëse fija SMARTCORE STICK™ zhvendoset ose hiqet nga mbajtësi.


| | | | |
|---|---|---|---|
| Hogarth Worldwide | Project and Job Number<br>**CR13082_H266288_P600287** | Client<br>**Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) |
| | Publication | Market<br>**Global** | Trim Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| | Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** |
| | Contact | | Date & Time<br>**19/05/2023 21:36** |

| | |
|---|---|
| Operator | Proofreader |
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black
LIGHT GREY

# Këshilla të shpejta





## DRITA PULSON ME NGJYRË TË VERDHË

Bateria është shkarkuar, duhet të ngarkohet.

## DRITAT PULSOJNË DY HERË ME NGJYRË TË BARDHË

IQOS ILUMA™ është jashtë intervalit të temperaturës së punës (0°C~40°C).






## DRITA PULSON ME NGJYRË TË KUQE

Rivendosni karikuesin e xhepit. Nëse drita e kuqe vazhdon të pulsojë, kontaktoni shërbimin e klientit.

## PËR TA RIVENDOSUR

Vendoseni mbajtësin në karikuesin e xhepit dhe shtypni butonin për 10 sekonda e më pas lëshojeni. Të gjitha dritat e statusit do të fiken dhe do të ndizen, për të konfirmuar rivendosjen.


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number | Client | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|
| CR13082_H266288_P600287 | Philip Morris International | |
| Publication | Market<br>Global | Trim Box (h x w)<br>140.00 x 80.00 mm |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>140.00 x 80.00 mm |
| Contact | | Date & Time<br>19/05/2023 21:36 |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black
LIGHT GREY
RED
YELLOW

IQOS
ILUMA

⚠ Ky është simboli i alarmit të sigurisë. Përdoret për t'ju njoftuar se ka rreziqe të mundshme lëndimesh fizike.

# PARALAJMËRIME DHE UDHËZIME SIGURIE

**JU LUTEMI T'I LEXONI TË GJITHA PARALAJMËRIMET DHE UDHËZIMET E SIGURISË PËRPARA PËRDORIMIT, PËR TË SHMANGUR LËNDIMET.**

**Këto paralajmërime dhe udhëzime të sigurisë nuk mund t'i mbulojnë të gjitha situatat e mundshme që ka gjasa të ndodhin, ndaj përdoruesit duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm.**

## RUAJINI KËTO PARALAJMËRIME DHE UDHËZIME PËR T'IU REFERUAR NË TË ARDHMEN, PASI PËRMBAJNË INFORMACIONE TË RËNDËSISHME.

Këto paralajmërime dhe udhëzime të sigurisë janë të vlefshme për IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™

**Përdoruesit e synuar**

- IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ janë vetëm për të rritur.
- IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ dhe fijet SMARTCORE STICKS™ janë për të rritur, të cilët do të vazhdonin gjithsesi të përdornin duhanin ose produkte me përmbajtje nikotine.
- Fëmijët dhe adoleshentët nuk duhet të përdorin asnjëherë IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ ose fijet SMARTCORE STICKS™ në asnjë rrethanë.
- Ky produkt nuk duhet të përdoret nga persona me aftësi të reduktuara fizike, shqisore ose mendore, apo me mungesë njohurish, përveçse nëse mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e produktit në mënyrë të sigurt dhe i kuptojnë rreziqet e përfshira.

**Duhani dhe nikotina**

- Fijet SMARTCORE STICKS™ përmbajnë nikotinë, e cila krijon varësi.
- IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ dhe SMARTCORE STICKS™ nuk janë pa rrezik. Mënyra më e mirë për të zvogëluar rreziqet shëndetësore të lidhura me duhanin është lënia plotësisht e përdorimit të tij dhe nikotinës.
- Nikotina është e pranishme në mënyrë të natyrshme në duhanin e përdorur në fijet SMARTCORE STICKS.


| Hogarth Worldwide | Project and Job Number: CR13082_H266288_P600287 | Client: Philip Morris International | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|---|
| | Publication | Market: Global | Trim Box (h x w): 140.00 x 80.00 mm |
| | Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w): 140.00 x 80.00 mm |
| | Contact | | Date & Time: 19/05/2023 21:36 |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

- Disa përdorues mund të kenë dhimbje barku, dhimbje gjoksi, ndjesi të mbytjes, kollë, vështirësi në frymëmarrje, marrje mendsh, gojë të thatë, grykë të thatë, probleme me mishrat e dhëmbëve, dhimbje koke, parehati, bllokim hundësh, të përziera, acarim të gojës, takikardi, acarim të fytit dhe të vjella.
- Produktet që përmbajnë nikotinë nuk duhet të përdoren nga njerëz që vuajnë ose rrezikojnë të preken nga sëmundje të zemrës, janë diabetikë, epileptikë ose kanë kriza.
- Produktet që përmbajnë nikotinë nuk duhet të përdoren gjatë shtatzënisë ose gjatë ushqyerjes me gji. Nëse jeni shtatzënë, ushqeni me gji ose dyshoni se jeni shtatzënë, duhet të hiqni dorë plotësisht nga përdorimi i duhanit dhe nikotinës.
- Lënia e duhanit ose kalimi në IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ dhe fijet SMARTCORE STICKS™ ose produktet e tjera që përmbajnë nikotinë mund të kërkojë rregullimin e dozës së disa ilaçeve (p.sh. teofilina, klozapina, ropiniroli).
- Në rast se nuk jeni të sigurt nëse mund të përdorni IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ ose fije SMARTCORE STICKS™ si pasojë e një problemi ekzistues shëndetësor, këshillohuni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.

## ⚠ INFORMACIONE TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË

**⚠ PARALAJMËRIM** **Rreziku i mbytjes dhe gëlltitjes**

Mbajini IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ dhe fijet SMARTCORE STICKS™ larg nga fëmijët dhe kafshët shtëpiake.

- RREZIK MBYTJEJE — Fijet SMARTCORE STICKS™ përmbajnë pjesë të imëta metalike me skaje të mprehta.
- RREZIK GËLLTITJEJE
  - Nëse gëlltiten fijet SMARTCORE STICKS™ mund të shkaktojnë dëmtime serioze të organeve të brendshme, si pasojë e pjesëve të imëta metalike me skaje të mprehta.
  - Nëse gëlltiten fijet SMARTCORE STICKS™ mund të përbëjnë rrezik helmimi nga nikotina.
  - Nëse gëlltiten fijet SMARTCORE STICKS™, kërkoni menjëherë ndihmë nga mjeku.
- RREZIK NGA TRAJTIMI — Mos i çmontoni fijet SMARTCORE STICKS™ pasi përmbajnë pjesë të imëta metalike me skaje të mprehta. Gjithmonë flakini fijet SMARTCORE STICKS™ menjëherë pas përdorimit, në përputhje me rregulloret lokale të asgjësimit të mbetjeve.

**⚠ PARALAJMËRIM** **Rreziqet nga pjesët elektronike dhe bateria**

Rreziqet elektrike

Mosrespektimi i këtyre paralajmërimeve dhe udhëzimeve të sigurisë mund të rezultojë në zjarr, shpërthim, goditje elektrike, lëndim ose dëmtim të produktit apo pronave të tjera:

- IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ duhet të përdoren vetëm nga përdoruesit e synuar.
- Mos e përdorni IQOS ILUMA™ or IQOS ILUMA PRIME™ në vendet ku ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike.


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number<br>CR13082_H266288_P600287 | Client<br>Philip Morris International | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|
| Publication | Market<br>Global | Trim Box (h x w)<br>140.00 x 80.00 mm |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>140.00 x 80.00 mm |
| Contact | | Date & Time<br>19/05/2023 21:36 |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

- Mos i karikoni ose mos i përdorni IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ ose aksesorët nëse dëmtohen, modifikohen ose prishen.
- Mos e përdorni IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ nëse bateria duket se ka rrjedhje.
- IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ karikojini vetëm në ambiente të brendshme, siç tregohet nga simboli ⌂, duke përdorur një kabllo karikimi të miratuar nga prodhuesi (përfshirë në ambalazh) dhe përshtatës energjie (përfshirë në ambalazh) për qëllime karikimi. Mos përdorni aksesorë të pamiratuar nga prodhuesi. Referojuni seksionit "Të dhënat teknike" dhe faqes së internetit www.iqos.com për detajet e pajisjes që keni blerë.
- Ky produkt duhet të karikohet vetëm me tension shumë të ulët për arsye sigurie. Për detaje, referojuni seksionit të të dhënave teknike të këtij udhëzuesi përdorimi.
- Mos e përdorni, mos e karikoni dhe mos e vendosni IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ në vende me temperaturë të lartë (si brenda një makine gjatë verës ose pranë burimeve të nxehtësisë, siç janë radiatorët apo oxhakët).
- Mos e përdorni IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ kur ka të pranishme materiale, lëngje dhe gaze që marrin flakë.
- IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™, përshtatësi i energjisë dhe kablloja e karikimit nuk duhet të ekspozohen ndaj asnjë lëngu. Mos i prekni ata nëse lagen ose janë zhytur në ndonjë lëng.


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number | Client | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|
| **CR13082_H266288_P600287** | **Philip Morris International** | |
| Publication | Market **Global** | Trim Box (h x w) **140.00 x 80.00 mm** |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w) **140.00 x 80.00 mm** |
| Contact | | Date & Time **19/05/2023 21:36** |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

- Mos e pastroni mbajtësin me agjentë pastrues.
- Pastrojeni në mënyrë periodike portën e karikimit USB të IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™, për të shmangur grumbullimin e grimcave të huaja (siç janë grimcat e pluhurit) dhe kontrolloni portën USB nëse ka materiale të huaja para se të përdorni konektorin USB.
- Trajtojeni me kujdes. IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ nuk duhet të bjerë përtokë dhe nuk duhet të pësojnë goditje të forta.
- Ky produkt nuk përmban pjesë që mund të riparohen nga përdoruesi. Mos u përpiqni të hapni, t'i bëni shërbime, të modifikoni ose të riparoni ndonjë komponent të IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ ose të zëvendësoni ndonjë nga komponentët e baterive.
- Karikuesi i xhepit dhe mbajtësi IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ nuk përputhen me versionet e mëparshme të IQOS. Mos u përpiqni ta karikoni mbajtësin IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ në një karikues xhepi IQOS të një versioni të mëparshëm. Mos u përpiqni të karikoni asnjë mbajtës IQOS të një versioni të mëparshëm në karikuesin e xhepit IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™.
- Mos e përdorni këtë produkt nëse është ekspozuar ndaj të ftohtit, të nxehtit ose lagështisë së madhe.
- Mos e prekni IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ dhe/ose aksesorët e tij nëse tejnxehen, lëshojnë shkëndija, tym, marrin flakë ose digjen. Nëse është rasti dhe është e mundur, kujdesuni që të mbyllni ose të shkëputni ushqyesin.


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number | Client | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|
| CR13082_H266288_P600287 | Philip Morris International | |
| Publication | Market | Trim Box (h x w) |
| | Global | 140.00 x 80.00 mm |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w) |
| | | 140.00 x 80.00 mm |
| Contact | | Date & Time |
| | | 19/05/2023 21:36 |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

- Mos u përpiqni të futni asnjë objekt në dhomëzën ngrohëse, përveç fijeve SMARTCORE STICKS™.
- Pajisja mund të përdoret vetëm në temperaturat >0°C/<40°C.
- Fijet SMARTCORE STICKS™ janë vetëm për një përdorim dhe nuk duhet të ripërdoren asnjëherë, as të ndizen me shkrepëse, çakmak ose çdo burim tjetër zjarri.

**Rreziqet e baterisë**

IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ ushqehen me bateri me jone-litiumi (Li-ion) të mbyllura. Në kushte normale përdorimi, bateria është e vulosur. Nëse vëreni se bateria rrjedh, ndiqni këto masa paraprake:

- Nëse gëlltitet lëngu që rrjedh nga bateria, kërkoni menjëherë kujdes mjekësor. Mos provokoni të vjella, mos hani ushqim dhe mos pini.
- Nëse thithet avulli i lëngut që rrjedh nga bateria, merrni ajër të pastër dhe kërkoni kujdes mjekësor.
- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria bie në kontakt me lëkurën, lani zonën e prekur, duke përfshirë duart dhe mos prekni sytë.
- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria bie në kontakt me sytë, shpëlajini menjëherë me ujë të rrjedhshëm për të paktën 15 minuta dhe kërkoni menjëherë kujdes mjekësor.

**⚠ KUJDES** **Rrezik nga aerosoli i nxehtë**

- Nëse e përdorni IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ në kushte moti të nxehtë dhe të lagësht, uji në aerosol bën që temperatura e aerosolit të ndihet shumë e nxehtë.
- Për ta shmangur këtë ndjesi, ruajini fijet SMARTCORE STICKS™ në një vend të pastër, të thatë dhe të freskët. Mos e ekspozoni produktin në kushte me lagështi të lartë ose nën rrezatimin e drejtpërdrejtë të diellit.
- Mos i përdorni fijet SMARTCORE STICKS™ të cilat janë ekspozuar ndaj nxehtësisë apo lagështisë së tepërt.
- Mos e hiqni fijen SMARTCORE STICK™ kur është në përdorim.
- Nëse ndieni shqetësime, ndaloni së përdoruri produktin dhe kontaktoni një profesionist të kujdesit mjekësor.

**⚠ KUJDES** **Rrezik reaksioni alergjik**

- Përdorimi i IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ mund të shkaktojë reaksion alergjik, si ënjtje të fytyrës, buzëve, gjuhës, mishrave të dhëmbëve, fytit apo trupit, vështirësi në frymëmarrje ose gulçime.
- Ndaloni përdorimin e IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ dhe kërkoni menjëherë kujdes mjekësor nëse keni ndonjë nga simptomat e listuara më lart, pasi ato mund të tregojnë një reaksion alergjik serioz.

**Përdorimi i fijeve SMARTCORE STICKS**

- Përdoreni IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ me fijet SMARTCORE STICKS™ të projektuara posaçërisht për pajisjet IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA™.
- Mos e përdorni asnjëherë IQOS ILUMA™ ose IQOS ILUMA PRIME™ me një cigare ose produkte të ngjashme.


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number | Client | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|
| CR13082_H266288_P600287 | Philip Morris International | |
| Publication | Market: Global | Trim Box (h x w): 140.00 x 80.00 mm |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w): 140.00 x 80.00 mm |
| Contact | | Date & Time: 19/05/2023 21:36 |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

- Mos i përdorni fijet SMARTCORE STICKS™ me versionet e mëparshme të pajisjeve IQOS.
- Mos i modifikoni fijet SMARTCORE STICKS™ në asnjë mënyrë ose mos shtoni asnjë substancë në fijet SMARTCORE STICKS. Një gjë e tillë mund të shkaktojë lëndime.

**Ruajtja**

- Pajisja duhet të ruhet në një vend të pastër, të thatë dhe të freskët. Mos e ruani në temperatura mbi 60°C.
- Të ruhet në një vend të paarritshëm nga fëmijët.

**Raportimi i përvojave ose incidenteve të pakëndshme**

- Nëse keni ndonjë efekt shëndetësor të padëshiruar kur përdorni IQOS ILUMA™, IQOS ILUMA PRIME™ dhe/ose fijet SMARTCORE STICKS, këshillohuni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.
- Ju mund të raportoni çdo përvojë ose incident të pakëndshëm drejtpërdrejt duke kontaktuar me qendrën lokale të Kujdesit të Klientit (detajet mund t'i gjeni në broshurën Kujdesi i Klientit). Duke raportuar efektet anësore, ju mund të ndihmoni për të siguruar më shumë informacione për sigurinë e këtij produkti.
- Për më shumë informacione, ju lutemi të vizitoni www.iqos.com

## TË DHËNAT TEKNIKE

**Mbajtësi:**

IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™
Modeli C1402

Lloji i baterisë: Bateria
e rikarikueshme me Li-ion

Në hyrje: 5 V ⎓ 1,6 A

**Karikuesi i xhepit:**

IQOS ILUMA PRIME™
Modeli C1502

Lloji i baterisë: Bateria
e rikarikueshme me Li-ion

Në hyrje: 5 V ⎓ 2 A

Bluetooth® 5.0

**Karikuesi i xhepit:**

IQOS ILUMA™
Modeli M0001

Lloji i baterisë: Bateria
e rikarikueshme me Li-ion

Në hyrje: 5 V ⎓ 2 A

Bluetooth® 5.0

Karikuesit e xhepit IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ janë shënuar me simbolin të ndjekur nga "SxxAxx," që tregon se karikuesit e xhepit IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ mund të karikohen duke përdorur një nga modelet e miratuara të përshtatësve të energjisë, të listuara më poshtë.

**Përshtatësi i energjisë:**

Modeli: S52A21, S21A20, S21A22, S21A23, S21A25, S21A27, S82A40, S82A41, S82A42, S82A43, S82A45, S82A46

Në hyrje: 100 V-240 V~50-60 Hz 0,3 A

Në dalje: 5 V ⎓ 2 A

Fuqia në dalje: 10,0 W

Efikasiteti aktiv mesatar: 79,0%

Konsumi i energjisë pa karikim: <0,09 W

**Përdorimi me kabllin e karikimit**


Hogarth Worldwide

| Project and Job Number | Client | Type Area Box (h x w) | Operator | Proofreader |
|---|---|---|---|---|
| CR13082_H266288_P600287 | Philip Morris International | | | |
| Publication | Market: Global | Trim Box (h x w): 140.00 x 80.00 mm | Line Manager | Account Manager |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w): 140.00 x 80.00 mm | Light Box | Light Box |
| Contact | | Date & Time: 19/05/2023 21:36 | | |

GREY
Black

## INFORMACION PËR FLAKJEN E IQOS ILUMA™ DHE IQOS ILUMA PRIME™

**E vlefshme për Bashkimin Europian dhe ZEE**

Ky simbol në produkt ose në paketimin e tij tregon se ky produkt dhe pjesët e tij individuale (duke përfshirë bateritë) nuk duhet të flaken me mbeturinat e tjera shtëpiake. Është përgjegjësia juaj të flakni mbetjet e pajisjes tuaj, duke e dorëzuar në një pikë grumbullimi të caktuar për riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Përveç kësaj, bateritë e flakura mund të kthehen pa pagesë në pikën e shitjes. Grumbullimi dhe riciklimi i klasifikuar i mbetjeve të pajisjeve tuaja në momentin e flakjes ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore dhe në garantimin e një riciklimi në mënyrë të tillë që mbron shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Flakja e mbetjeve të pajisjeve si mbeturina komunale të paklasifikuara (p.sh. me djegie të mbeturinave ose në landfill) mund të ketë efekte negative në mjedis dhe për shëndetin e njeriut. Për më shumë informacion lidhur me pikat ku mund të flakni mbetjet e pajisjeve tuaja për riciklim, ju lutemi të kontaktoni zyrën lokale të organeve vendore, shërbimin lokal të asgjësimit të mbetjeve shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin. Importuesi lokal i produktit do të kujdeset për financimin e trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve të pajisjeve të kthyera përmes këtyre pikave të posaçme të grumbullimit, në përputhje me kërkesat vendore.

## UDHËZIME PËR HEQJEN E BATERISË (PËR FLAKJEN DHE RICIKLIMIN)

**Bateritë nuk duhet të hiqen nga klienti. Në fund të jetëgjatësisë së produktit, vetëm ricikluesit e autorizuar mund t'i heqin bateritë në mënyrë të sigurt duke ndjekur hapat e mëposhtëm.**

Karikuesi i xhepit IQOS ILUMA PRIME™ (Modeli C1502):

Hapi 1: Pajisja duhet të jetë plotësisht e shkarkuar, para se të çmontohet.

Hapi 2: Hiqni/shqitni shtresën e gomuar nga kapaku kozmetik i karikuesit të xhepit.

Hapi 3: Hiqni 2 vidhat.

Hapi 4: Hiqni kapakun kozmetik duke e rrëshqitur dhe lëvizur vertikalisht nga kasa metalike, e më pas zhvidhosni 2 vidhat e skeletit.

Hapi 5: Shkëputni gjithë qarqet e printuar fleksibël dhe konektorin për të hequr bordin e qarkut të printuar të karikuesit.

Hapi 6: Hiqni baterinë duke e anuar nga lart dhe flakeni në përputhje me rregulloret lokale.

Karikues xhepi IQOS ILUMA™ (Modeli M0001):

Hapi 1: Pajisja duhet të jetë plotësisht e shkarkuar para se ta çmontoni.

Hapi 2: Hiqni kapakun e derës kozmetike me gishta.

Hapi 3: Hapni derën dhe zhvidhosni vidhën e poshtme dhe të sipërme.

Hapi 4: Hiqni folenë e karikuesit.

Hapi 5: Zhvidhosni pllakën e qarkut elektronik (vetëm 1 vidhë).

Hapi 6: Hiqni bashkuesin e baterisë në pllakën e qarkut. Mos i pritni fijet e baterisë.

Hapi 7: Hiqeni baterinë duke e anuar dhe asgjësojeni në përputhje me rregulloret lokale.

Mbajtësja IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ (Modeli C1402):

Hapi 1: Pajisja duhet të jetë plotësisht e shkarkuar, para se të çmontohet.

Hapi 2: Hapni unazën.

Hapi 3: Hapni kapakun e mbajtësit, rrëshqiteni jashtë nga kasa.

Hapi 4: Shqiteni paketën e baterisë dhe ngrijeni lart.

Hapi 5: Hiqni baterinë dhe flakeni në përputhje me rregulloret lokale.


Hogarth Worldwide

| | | | |
|---|---|---|---|
| Project and Job Number<br>**CR13082_H266288_P600287** | Client<br>**Philip Morris International** | Type Area Box (h x w) | |
| Publication | Market<br>**Global** | Trim Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** | |
| Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>**140.00 x 80.00 mm** | |
| Contact | | Date & Time<br>**19/05/2023 21:36** | |

| | |
|---|---|
| Operator | Proofreader |
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black

**Konfirmimi i përputhshmërisë**
Kështu, Philip Morris Products S.A. deklaron se IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ janë në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Deklaratën e konformitetit mund ta gjeni në: www.pmi.com/declarationofconformity

IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ punojnë në brezin e frekuencave 2.402 – 2.480 GHz me një fuqi maksimale të prodhimit RF që është nën 10.0 dBm.

Kjo pajisje është në përputhje me kufijtë e ekspozimit RF dhe është vlerësuar në përputhje me kushtet e ekspozimit sipas EN 62311:2008.

Projektuar dhe prodhuar nën autoritetin e Philip Morris Products S.A., Quai Jeanrenaud 3, 2000 Neuchâtel, Zvicër.

Bluetooth®

Marka dhe logot e Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i markave të tilla nga Philip Morris Products S.A. dhe bashkëpunëtorëve të tij është i licencuar. Markat e tjera tregtare dhe emrat tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.

Informacionet e mëtejshme lidhur me licencën e firmuerit për IQOS ILUMA™ dhe IQOS ILUMA PRIME™ i gjeni në www.iqos.com.

Jo të gjitha pajisjet e listuara në këto paralajmërimet dhe udhëzimet e sigurisë përfshihen në këtë paketë riparimi.

© 2021 Copyright Philip Morris Products S.A.

CE

| Hogarth Worldwide | Project and Job Number<br>CR13082_H266288_P600287 | Client<br>Philip Morris International | Type Area Box (h x w) |
|---|---|---|---|
| | Publication | Market<br>Global | Trim Box (h x w)<br>140.00 x 80.00 mm |
| | Insertion Date | Operator | Bleed Box (h x w)<br>140.00 x 80.00 mm |
| | Contact | | Date & Time<br>19/05/2023 21:36 |

| Operator | Proofreader |
|---|---|
| Line Manager | Account Manager |
| Light Box | Light Box |

GREY
Black